



MINISTRIA E EKONOMISE DHE FINANCAVE
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSJE
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE

Kabinet i Ministrut - Kabinet Ministra - Cabinet of Minister

Ref. No: 1243

Date: 5.11.2007
Agim



UNMIK

IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE NË KOSOVË

INSTITUCIJE PRIVREMENE SAMOUPRAVE NA KOSOVU

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT OF KOSOVO

| QEVERIA E KOSOVËS | GOVERNMENT OF KOSOVO | VLADA KOSOVA |
|--------------------------|----------------------|------------------------|
| Ministria e Shëndetësisë | Ministry of Health | Ministarstvo zdravstva |

Udhëzimi Administrativ 04 / 2007

**Mbledhja dhe shfrytëzimi i mjeteve nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve
të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrave vetanake të institucioneve
shëndetësore**

Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave

1. Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 "Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës", duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, "Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkoohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë", Neni 1.3 (d); Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 "Amandamentimi i Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkoohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë" Shtojca VI (iii),
2. Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë së Shëndetësisë me Rregulloren Nr. 2002/5 të datës 04 Mars 2002, posaçërisht me shtojcën vi, paragrafin (i) që e autorizon Ministrinë, për ta zhvilluar politikën shëndetësore dhe të zbatojë legislacionin për një sistem jo diskriminues dhe të përgjegjishëm të kujdesit shëndetësor dhe me paragrafin (ii) që e autorizon Ministrinë të bashkërendojë ofrimin e aktiviteteve në sektorin e Shëndetësisë në mënyrë që ta përparojë zhvillimin koherent të politikës së mbrojtjes shëndetësore;
3. Në pajtim me autoritetin që i është dhënë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe me Rregulloren e UNMIK 2006/61;

ASL

4. Me qëllim të përmirësimit të sistemit të tanishëm të bashkëpagesave dhe shfrytëzimit të tyre;
5. I vendsur që të sigurojë cilësinë dhe shfrytëzimin racional të shërbimeve shëndetësore;
6. Duke pas parasysh kufizimet e Urdhëresës administrative 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës;
7. Me qëllim të plotësimit të fondeve në dispozicion për kujdesin shëndetësor, respektimit të sistemit të referimit nga kujdesi parësor, në kujdesin dytësor dhe tretësor shëndetësor, ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara si dhe shfrytëzimit racional të shërbimeve shëndetësore në të gjitha institucionet publike shëndetësore: punktet, qendrat e mjekësisë familjare (QMF), qendrat kryesore të mjekësisë familjare (QKMF), spitalet, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK), qendrat për shëndet mendor, shtëpitë e mbrojtura, Instituti për Shëndet Publik i Kosovës, Instituti për Mjekësi të Punës në Gjakovë, Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, Qendrat e Rehabilitimit dhe të Mjekësisë Fizikale, Qendra e Mjekësisë së Sportit, AKPM si dhe barnatoret në QKMF(për barnat nga List Esenciale e Barërave);
8. Duke pas parasysh Vendimin e Qeverisë 02/240 të datës 28.02.2007, për të përcaktuar format e mbledhjes, kategoritë dhe çmimet e shërbimeve, nxjerr:

Neni 1
Dispozitat e Përgjithshme

- 1.1 Ky Udhëzim Administrativ irregullon procedurat për grumbullimin e mjeteve nga të hyrat vetanake dhe bashkëpagesat, kategoritë dhe çmimet për shërbime shëndetësore në institucionet publike shëndetësore.
- 1.2 Me Memorandumin e Mirëkuptimit, tash e tutje (MiM), që do të nënshkruhet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për vitin 2007, në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullores së UNMIK-ut 2006/61, do të përcaktohet shfrytëzimi dhe destinimi i mjeteve të mbledhura sipas këtij udhëzimi administrativ.
- 1.3 Mjetet e mbledhura nga të hyrat vetanake dhe bashkëpagesat për shërbime shëndetësore, janë para publike dhe do të trajtohen sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe rregullave financiare të thesarit.

Neni 2
Lënda dhe qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave, irregullon në mënyrë unike, mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga

të hyrat vetanake dhe bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore në gjithë sektorin publik shëndetësor në Kosovë.

Neni 3 **Bashkë pagesat për shërbime shëndetësore**

3.1.Bashkëpagesat janë para publike në bazë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të cilat paguhen nga shfrytëzuesit e shërbimeve publike shëndetësore.

3.2.Bashkë pagesat për shërbime shëndetësore, janë mjete shtesë, shfrytëzimi i të cilave rregullohet përmes MiM të nënshkruar në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

3.3.Institucionet shëndetësore publike, që detyrohen të mbledhin bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore janë:

- a) punktet, qendrat e mjekësisë familjare (QMF), qendrat kryesore të mjekësisë familjare (QKMF), spitalet, Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK), qendrat për shëndet mendor, shtëpitë e mbrojtura, Instituti Kombëtar për Shëndet Publik i Kosovës, Instituti për Mjekësi të Punës në Gjakovë, Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, Qendrat e Rehabilitimit dhe të Mjekësisë Fizikale, Qendra e Mjekësisë së Sportit, Agjencioni Kosovar për Produkte Medicinale si dhe barnatoret në QKMF (për barnat nga Lista Esenciale e Barërave).

3.4.Të gjitha institucionet shëndetësore, shfrytëzojnë mjetet nga bashkëpagesat duke i respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

3.5.Çdo institucion shëndetësor duhet të vendos lajmërim mbi vlerën e bashkëpagesave të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe njoftim për kategoritë e qytetarëve dhe llojet e shërbimeve shëndetësore, që janë të liruara nga bashkëpagesa.

3.6. Lajmërimi dhe Njoftimi duhet të vendosen në:

- a) hyrje të institucionit shëndetësor,
- b) të gjitha vendet për pritje,
- c) të gjitha pikat ku bëhen bashkëpagesat.

3.7.Çdo shfrytëzuesi të shërbimeve shëndetësore, për kryerjen e shërbimeve të cilat janë në listën e bashkëpagesave të shërbimeve shëndetësore, duhet t'i lëshohet dëftesa me numrin serik nga blloku dhe të registrohet në librin e protokollit.

3.8.Për kryerjen e shërbimeve të cilat janë në listën e bashkëpagesave të shërbimeve shëndetësore, shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore të liruar nga bashkëpagesat sipas këtij udhëzimi administrativ, u lëshohet dëftesa, ku shënohet vlera e bashkë

pagesës me shënimin “lirohet”, dhe regjistrohet në librin përkatës duke shënuar nenin dhe paragrafin përkatës, me të cilin ai lirohet nga bashkëpagesa.

3.9.Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore do të bëhen në bazë të vlerave të paraqitura në Tabelat 1 dhe 2 të këtij udhëzimi administrativ.

3.10.Çmimet e bashkëpagesave për shërbime shëndetësore për shtetas të huaj dhe bartës të sigurimeve të huaja do të janë për pesë (5) herë më të larta se sa çmimi aktual i bashkëpagesës për banorët e Kosovës, deri në përpilimin e listës së çmimeve të shërbimeve shëndetësore nga Ministria e Shëndetësisë.

Neni 4 **Të hyrat vetanake**

4.1.Institucionet shëndetësore publike që krijojnë të hyra vetanake në Ministrinë e Shëndetësisë janë :

a)AKPM-Agjensioni Kosovar për Produkte Medicinale, Ministria e Shëndetësisë, kodi buxhetor-Mjekët Rezident (Bordi për Regjistrim dhe Licencim, Bordi Qendror për Edukim Specialistik), IKSHPK-Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës Divizioni i Praksës Private (Bordi për Licencimin e Institucioneve shëndetësore Private), Inspektorati Shëndetësor i Kosovës, Inspektorati Sanitar i Kosovës, Institucionet e kujdesit shëndetësor dytësor dhe tretësor (spitalet rajonale, QKUK-Qendra Klinike Universitare e Kosovës, QKSUK-Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës), Instituti i Mjekësisë së Punës Gjakovë, Qendra e Telemjekësisë, QKKTGJ – Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut.

4.2.Institucionet shëndetësore i realizojnë të hyrat vetanake përmes aktiviteteve kryesore dhe të veçanta, bazuar në Ligjin për Shëndetësi Nr. 4/2004, Ligji për veprimtari private në shëndetësi Nr.50/2004, Ligji i Inspektoratit Shëndetësor Nr.02/L-38, Ligji i Inspektoratit Sanitar Nr.22/2003, Udhëzimi administrativ 14/2000, Udhëzimi administrativ 10/2003, Udhëzimi administrativ 10/2005 dhe Udhëzimi administrativ 15/2006.

4.3.Të gjitha institucionet shëndetësore nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguara të hartojnë planin vjetor të hyrave vetanake dhe shpenzimeve, sipas programeve buxhetore, aktiviteteve dhe kategorive ekonomike, të cilat do të janë në pajtim me këtë udhëzim administrativ dhe me MiM përkatës të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Neni 5 **Përjashtimet nga bashkë pagesa**

5.1.Përjashtohen nga lista e bashkëpagesave, shërbimet shëndetësore dhe grupet e veçanta të popullatës, në përputhje me:

- a) Ligjin për Shëndetësi, Nr. 4/2004, nenin 22,
- b) Ligjin për Kujdesin Shëndetësor Emergent Nr.02/L-50, nenin 13,

XSA

- c) Ligjin për Familjen, Nr. 32/2004, nen 5 paragrafi 1 dhe nen 7, paragrafi 1,
 - d) Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimate Civile të Luftës, nen 5, paragrafet 3, 4, 5, dhe 7; nen 6, paragrafi 12; nen 7, paragrafet 3, 4 dhe 5; nen 10, paragrafi 2 dhe nen 11, paragrafi 2 .
- 5.2. Përjashtohen nga bashkëpagesat edhe format e përcaktuara me nenin 22.2 të Ligjit për Shëndetësi, Nr. 4/2004 si :
- a) kujdesi shëndetësor parandalues,
 - b) kujdesi shëndetësor reproduktiv, që përfshin masat e planifikimit të familjes dhe kujdesin shëndetësor gjatë shtatëzënisë, lindjes dhe lehonisë,
 - c) kujdesi shëndetësor për pacientët të cilët lëngojnë nga sëmundjet, çrrëgullimet dhe lëndimet të cilat rrezikojnë seriozisht ose vështirësojnë jetën e tyre, të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Ministria e Shëndetësisë,
 - d) sëmundjet infektive të përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike dhe Ministria e Shëndetësisë në listën për sëmundje infektive sipas këtij udhëzimi administrativ,
 - e) personat me aftësi të kufizuara,
 - f) psikozat,
 - g) kujdesi shëndetësor për qytetarin në stadin terminal që ofrohet në shtëpinë e qytetarit nga ana e Qendrës së Mjekësisë Familjare .

Neni 6 Referimi dhe bashkë pagesat

6.1. Me qëllim të shfrytëzimit racional të kapacitetave të institucioneve shëndetësore, nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, kërkohet që të respektojnë këtë sistem të referimit:

- a) vizita e parë duhet të bëhet në punkt apo në qendrën e mjekësisë familjare (QMF), përveç në rastet urgjente,
- b) vizita mjekësore në institucionet e nivelit dytësor shëndetësor (si për shërbime specialistike ambulantore ashtu edhe për shërbime spitalore), duhet të bëhet vetëm në bazë të udhëzimit të mjekut nga punkti, qendra e mjekësisë familjare (QMF) ose në bazë të udhëzimit të mjekut nga institucioni shëndetësor në sektorin privat,
- c) vizita mjekësore në QKUK dhe QKSUK, duhet të bëhet në bazë të udhëzimit të mjekut specialist të institucionit të kujdesit dytësor shëndetësor ose nga ana e mjekut në institucionin e mjekësisë parësore dhe institucionin shëndetësor të sektorit privat në komunat e regjionit të Prishtinës,
- d) në situatat urgjente, aksidentet, gjendjet e papritura, gjendjet serioze shëndetësore që mund të kërcënojnë jetën dhe shëndetin, pacienti mund të dërgohet në institucionin më të afërt të kujdesit shëndetësor apo në institucionin që konsiderohet si më i përshtatshmi, duke pas parasysh natyrën urgjente të rastit.

6.2.Qytetarët të cilët veprojnë në kundërshtim, me nënparagrafin (a) të këtij nenit duhet të paguajnë çmimin e plotë të shërbimit, sikur është specifikuar në nenin 2, paragrafi 10 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 7
Regjistrimi i mjeteve të mbledhura nga bashkë pagesat

- 7.1.Regjistrimi i mjeteve të mbledhura nga bashkëpagesat, do të bëhet përmes dëftesave të veçanta për bashkëpagesa. Dëftesa duhet të përmbajë, pos tjerash, adresën dhe numrin personal të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore ose përcjellësit të tij dhe shifrën nga Klasifikimi Ndërkombëtar i Procedurave (KNP – 9 dhe ICD – 10).
- 7.2.Dëftesa me numrin serik do të vërteton të gjitha të ardhurat e mbledhura nga institucionet shëndetësore në bazë të bashkëpagesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore.
- 7.3. Dëftesa duhet të jetë me tri kopje, një kopje për shfrytëzuesin e shërbimeve shëndetësore, një kopje për evidencë kontabël dhe një kopje për institucionin shëndetësor (kopja që mbetet në bllokun e dëftesave). Kopjet e dëftesave, përfshirë edhe dëftesat e plotësuara me gabime, duhet të ruhen në bllokun e dëftesave.

Neni 8
Zbatimi dhe Mbikëqyrja

- 8.1.Çdo institucion shëndetësor, duhet të evidentojë në mënyrë të saktë të gjitha mjetet e mbledhura nga bashkëpagesat e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore sipas llojeve të shërbimeve për të cilat është kryer bashkëpagesa.
- 8.2.Të gjitha mjetet financiare të mbledhura nga institucioni shëndetësor në bazë të bashkëpagesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, duhet të depozitohen çdo ditë të punës, për çdo ditë të javës, ndaras. Një kopje e të gjitha fletëpagesave, së bashku me deklaratën që e pasqyron tërësinë e mjeteve financiare të depozituara, duhet të dorëzohet në fund të çdo muaji, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.
- 8.3.Barnatoret me barëra nga lista esenciale e barërave e Ministrisë së Shëndetësisë, obligohen të mbledhin bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimeve, sipas akteve ligjore në fuqi.
- 8.4.Shuma e mjeteve nga bashkëpagesat duhet të jetë transparente.

Neni 9
Shfrytëzimi i Mjeteve Financiare

- 9.1.Mjetet e grumbulluara financiare do të shfrytëzohen në pajtim me MiM të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për vitin 2007.

9.2.Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe të gjithë udhëheqësit e institucioneve shëndetësore, që të përgatisin planet e shfrytëzimit të mjeteve nga bashkëpagesat të lejuara sipas MiM.

9.3.Mjetet e mbledhura duhet shpenzuar në përputhje me ligjet dhe rregullat e parapara për shpenzimin e mjeteve publike.

Neni 10

Pagesa për punën gjatë kujdestarisë, punën e natës dhe stimulimi për punë në punkte të largëta

10.1.Puna gjatë kujdestarisë është definuar si obligim për të ofruar shërbime shëndetësore brenda institucionit shëndetësor gjatë 24 orëve:

- Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditët e rregullta të punës do të paguhet për intervalin kohor prej tetë (08) orësh, për periudhën 23:00 – 07:00. Për kujdestarinë në ditën e rregullt të punës, lejohet një ditë e lirë, të nesërmen pas kujdestarisë.
- Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e premte do të paguhet për gjashtëmbëdhjetë (16) orë të punës, për periudhën 15:00 – 07:00.
- Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e shtunë do të paguhet për 24 orë të punës, për periudhën 07:00 – 07:00.
- Ora e punës gjatë kujdestarisë në ditën e diele do të paguhet për gjashtëmbëdhjetë (16) orë të punës, për periudhën 15:00 – 07:00. Për kujdestarinë në ditën e diele, lejohet një ditë e lirë, të hënën pas kujdestarisë.

10.2. Puna gjatë natës është definuar si obligim për të ofruar shërbime shëndetësore brenda institucionit shëndetësor gjatë natës, si pjesë e punës në ndërrime.

- Ora e punës gjatë natës, si pjesë e punës në ndërrime, do të paguhet për intervalin kohor prej 23.00 - 07.00.

10.3.Varësish nga kategoria profesionale:

- Ora e punës gjatë kujdestarisë dhe ora e punës gjatë natës, do të paguhet 50 % më tepër se sa ora e rregullt e punës,
- Ora e punës gjatë festave shtetërore, do të paguhet 75 % më tepër se sa ora e rregullt e punës.

10.4.Për sqarim të këtij udhëzimi administrativ, si punkt i largët shëndetësor definohet institucioni shëndetësor i cili është mbi 5 km larg qendrës më të afërt të mjekësisë familjare.

- Varësish nga kategoria profesionale, stimulimi për punë në punkte të largëta shëndetësore do të jetë në vlerë prej 30 % të pagesës së rregullt mujore.

10.5.Parakusht për pagesat e lartpërmendura është plotësimi i kuotës së plotë të orëve të punës të parapara për një muaj.

**Neni 11
Përgjegjësia**

- 11.1. Menaxherët e institucioneve shëndetësore janë përgjegjës për organizimin, zbatimin mbikëqyrjen e grumbullimit të mjeteve nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore dhe për shfrytëzimin sa më racional të tyre.
- 11.2. Institucionet shëndetësore zbatojnë sistemin e bashkëpagesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, raportojnë vështirësitë eventuale dhe propozojnë përmirësimet në Ministrinë e Shëndetësisë.

**Neni 12
Procedurat e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm**

- 12.1. Ministria e Shëndetësisë, përmes zyrës së auditimit, do të ndërmarrë auditim të rregullt dhe ad hoc të procesit të mbledhjes, depozitimit dhe shfrytëzimit të bashkë pagesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, brenda institucioneve shëndetësore të të gjitha niveleve.
- 12.2. Me qëllim të përcjelljes së procesit të mbledhjes dhe depozitimit të bashkëpagesave nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore brenda institucioneve shëndetësore, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, do të ndërmarrë procedura të rregullta dhe ad hoc të auditimit.

**Neni 13
Dispozitat përfundimtare**


- 13.1. Mënyra e kompensimit nga neni 10 i këtij udhëzimi administrativ për kujdesin sekondar dhe terciar rregullohet sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr. 02/240 të datës 28.02.2007.
- 13.2. Mënyra e kompensimit nga neni 10 i këtij udhëzimi administrativ për kujdesin parësor shëndetësor është përgjegjësi e Kuvendeve Komunale.
- 13.3. Shtojca 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.

**Neni 14
Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativi, shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr.6/2006 për Bashkëpagesat dhe Shfrytëzuesit e Shërbimeve Shëndetësore dhe Shfrytëzimi i Mjeteve të Mbledhura i nxjerrur nga Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.



Prishtinë, 24.09. 2007

Shtojca 1 - a
Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelistëve parësor

| Nr | Lloji i shërbimit | € |
|----|--|------|
| 1 | Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë | 1.0 |
| 2 | Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes | 2.0 |
| 3 | Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes | 5.0 |
| 4 | Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente | 6.0 |
| 5 | Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike | 0.3 |
| 6 | Ultrazëri standard | 2.0 |
| 7 | Radiografia | 2.0 |
| 8 | EKG | 0.5 |
| 9 | Analizat laboratorike - vetëm hemogrami dhe urina | 1.0 |
| 10 | Analizat laboratorike (komplet) | 3.0 |
| 11 | Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 1.0 |
| 12 | Audiograma | 1.0 |
| 13 | Shpëlarja e veshit | 1.0 |
| 14 | Dhënia e injeksionit intramuskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente | 1.0 |
| 15 | Dhënia e injeksionit intravenoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente | 1.0 |
| 16 | Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë) | 3.0 |
| 17 | Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor | 1.0 |
| 18 | Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve | 18.0 |
| 19 | Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 18.0 |
| 20 | Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 5.0 |
| 21 | Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj - për një orë | 25.0 |



Shtoja 1 - b

Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit dytësor

| Nr | Lloji i shërbimit | € |
|----|--|------|
| 1 | Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të spitalit ose në Qendrën për Shëndet mendor, sipas udhëzimit të mjekut nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor | 3.0 |
| 2 | Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të spitalit ose në Qendrën për Shëndet mendor, pa udhëzim të mjekut nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor | 10.0 |
| 3 | Dita e qëndrimit në spital (vetëm dhjetë ditët e para, pastaj pa pagesë) për çdo ditë | 3.0 |
| 4 | Dita e qëndrimit në spital për personin shoqërues të pacientit më të vjetër se pesëmbëdhjetë vjeç për tërë kohën e qëndrimit në spital, për çdo ditë | 5.0 |
| 5 | Tomografia e kompjuterizuar – CT | 20.0 |
| 6 | Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatore, Ultrazëri standard | 3.0 |
| 7 | Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatore, Ultrazëri me Doppler | 5.0 |
| 8 | Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatore, RTG | 3.0 |
| 9 | Procedura mjekësore e kryer në mënyrë ambulatore, EKG | 1.0 |
| 10 | Analizat laboratorike - vetëm hemogrami dhe urina | 1.0 |
| 11 | Analizat laboratorike për shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore jashtëspitalore | 4.0 |
| 12 | Shërbimet në transfuzion të gjakut - Caktimi grupit të gjakut dhe Rh faktorit | 1.5 |
| 13 | Përcaktimi i HIV, HBS, HCV | 5.0 |
| 14 | Përcaktimi i T- 3, T- 4, TSH, | 5.0 |
| 15 | Përcaktimi i Tumormarkerëve | 1.5 |
| 16 | Ergometria | 5.0 |
| 17 | Holter monitorimi 24 orësh i EKG -së apo TA | 5.0 |
| 18 | EEG | 5.0 |
| 19 | EMNG | 5.0 |
| 20 | Bronkoskopia | 5.0 |
| 21 | Spirometria | 2.0 |
| 22 | Audiometria dhe vestibulometria | 5.0 |
| 23 | Shpëlarja e veshit | 1.5 |
| 24 | Gastroskopia | 5.0 |



| | | |
|----|--|------|
| 25 | Kolonoskopia | 5.0 |
| 26 | Rektoscopia | 5.0 |
| 27 | Cistoskopia | 5.0 |
| 28 | Procedurat mjekësore të kryera në mënyrë ambulatore: Lavazha e lukthit, klizma, kateterizimi i fshikzës urinare | 2.0 |
| 29 | Tretmani fiziatrik ditor | 1.5 |
| 30 | Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm në vizitën e parë) | 4.0 |
| 31 | Ndërprerja e shtatzënisë pa indikacion socio-medicinal | 30.0 |
| 32 | Ndërhyrje kirurgjike me anestezion lokal | 5.0 |
| 33 | Ndërhyrje kirurgjike me anestezion total me laparaskopi në gjinekologji dhe kirurgji si dhe artroscopi në ortopedi | 10.0 |
| 34 | Ndërhyrje kirurgjike me anestezion të përgjithshëm ose spinal | 20.0 |
| 35 | Detoksikimet e të alkoolizuarve në kushte ambulantorike | 5.0 |
| 36 | Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor | 1.5 |
| 37 | Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga konsiliumi i profesionistëve | 18.0 |
| 38 | Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 18.0 |
| 39 | Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 5.0 |

Shtojca 1 - c
Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelist tretësor –
QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVES

| Nr | Lloji i shërbimit | € |
|----|---|-------|
| 1 | Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të QKU sipas udhëzimit të mjekut nga Institucioni Regional i Kujdesit dytësor shëndetësor ose, për komunat e regionit të Prishtinës, nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor. | 4.0 |
| 2 | Ekzaminimi mjekësor në ambulancën specialistike të QKU pa udhëzim të mjekut nga Institucioni Regional i Kujdesit dytësor shëndetësor ose, për komunat e regionit të Prishtinës, pa udhëzim nga punkti, QMF, QKMF ose institucioni privat shëndetësor. | 12.0 |
| 3 | Vizita konziliare për pacientët jashtëspitalor | 15.0 |
| 4 | Dita e qëndrimit në spital (vetëm dhjetë ditët e para e pastaj pa pagesë), për çdo ditë | 4.0 |
| 5 | Dita e qëndrimit në spital për personin shoqërues të pacientit më të vjetër se 15 vjeq (për tërë kohën e qëndrimit në spital), për çdo ditë | 5.0 |
| 6 | Certifikata për lejen e vozitjes e lëshuar nga Konsiliumi i profesionistëve | 18.0 |
| 7 | Certifikata mjekësore e lëshuar sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 18.0 |
| 8 | Ekspertiza konziliare dhe dhënia e certifikatës | 20.0 |
| 9 | Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore | 5.0 |
| 10 | Laringoskopja direkte | 10.0 |
| 11 | Videolaringoskopja | 10.0 |
| 12 | Videolaringostroboskopja | 10.0 |
| 13 | Laringomikroskopja | 20.0 |
| 14 | Otomikroskopja | 10.0 |
| 15 | Rinoplastika estetike | 100.0 |
| 16 | Plastika e lapres se veshit - estetike | 100.0 |
| 17 | Endoskopja e hundës FEES | 10.0 |
| 18 | Audiometria objektive | 10.0 |
| 19 | Audiometria tonale (Audigramma) | 5.0 |
| 20 | Vestibulometria | 10.0 |
| 21 | Shpëlarja e veshít | 2.0 |
| 22 | Timpanogrami | 5.0 |
| 23 | Testi kalorik | 5.0 |
| 24 | Tamponada e përparme | 5.0 |
| 25 | Tamponada e pasme | 5.0 |
| 26 | Tracheobronchoscopy me anestezion të përgjithshëm | 20.0 |
| 27 | Direktoskopja (DSK) | 5.0 |
| 28 | Kauterizimi | 5.0 |

| | | |
|----|---|------|
| 29 | Intervenimet e vogla me qepje | 5.0 |
| 30 | Toaletë + lidhje me ndërrim fashe | 0.5 |
| 31 | ESK në anestezion të përgjithshëm | 20.0 |
| 32 | ESK (Ezofagoskopia) ne anestezion lokal + buzhimi | 10.0 |
| 33 | ENG (Elektronistagmografia) | 10.0 |
| 34 | EEG | 10.0 |
| 35 | EMNG | 10.0 |
| 36 | Laserofotokoagulimi | 10.0 |
| 37 | Spirometria | 3.0 |
| 38 | EKG | 1.0 |

Radiologjia

| | | |
|---|--|------|
| 1 | Tomografja e kompjuterizuar (CT) | 25.0 |
| 2 | Rezonanca manjetike (RM) | 30.0 |
| 3 | Echo (ultrazëri) – i abdomenit, urotraktit, gjendres tiroide dhe te regjioneve tjera | 10.0 |
| 4 | Ultrazëri me Doppler color | 12.0 |
| 5 | Ekokardiografia tranzesofageale | 15.0 |
| 6 | Rtg nativ | 4.0 |
| 7 | Rtg me kontrast | 5.0 |
| 8 | Histerosalpingografia | 10.0 |

Mjekësia nukleare

| | | |
|---|------------------|------|
| 1 | T3, T 4, TSH | 5.0 |
| 2 | Scintigrafia | 15.0 |
| 3 | Terapia me J 131 | 20.0 |

Instituti i fiziologjisë

| | | |
|---|---|------|
| 1 | FSH, LH, Prolaktin, Progesteron, Estradiol, Testosteron, Kortizol, Insulin, C- peptid, PSA (në bllok) | 10.0 |
| 2 | Testet alergjike - në bllok | 3.0 |

Instituti i Anatomisë Patologjike

| | | |
|---|---|------|
| 1 | Biopsia, Punksioni citologjik (FNA) dhe Strishoja citologjike për çdo analizë | 10.0 |
|---|---|------|

Instituti i mjekësisë ligjore

| | | |
|---|---|------|
| 1 | Certifikata për martesë - kurorë | 25.0 |
| 2 | Certifikata e Gjinekologjisë (përcaktimi i virgjërisë, etj) | 25.0 |
| 3 | Certifikata për dëmtime | 25.0 |
| 4 | Certifikata për dëmtime (vetëm) me dokumente mjekësore | 25.0 |

Instituti i Fiziologjisë Patologjike

| | | |
|---|-------------------|-----|
| 1 | Analizat në bllok | 5.0 |
|---|-------------------|-----|

Instituti i Biokimisë

| | | |
|---|--|-----|
| 1 | Analizat laboratorike hematologjike dhe biokimike për shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore jashtëspitalore - në bllok | 5.0 |
| 2 | Tumormarkerët - sipas organit | 2.0 |

Analizat Citogenetike

| | | |
|---|-----------------|------|
| 1 | Për çdo analizë | 10.0 |
|---|-----------------|------|

Sherbimi i Hematologjisë

| | | |
|---|--|------|
| 1 | Hematokriti, Hgb, Le, Tr, Er | 3.0 |
| 2 | Strishoja e gjakut periferik me koment | 10.0 |

Sherbimi i Gastroenterologjise

| | | |
|---|-----------------------------------|------|
| 1 | Ezofagogastroduodenoskopija | 10.0 |
| 2 | Rektoskopija | 10.0 |
| 3 | Sigmoidoskopija | 10.0 |
| 4 | Ligatura—sklerozimi i hemoroideve | 5.0 |

Shërbimi i Kardiologjisë

| | | |
|---|---|-------|
| 1 | Ergometria | 10.0 |
| 2 | Holter monitorimi 24 orëshi EKG-së apo TA | 10.0 |
| 3 | Pericardiocenteza | 15.0 |
| 4 | “Pace maker” i përkohshëm | 50.0 |
| 5 | “Pace maker” i përhershëm | 100.0 |

Kardiologjia Invazive

| | | |
|----|---|-------|
| 1 | Kateterizimi i zemrës se djathte: | |
| a | Ventrikulografia | 60.0 |
| b | Matja e shtypjes ne sistemin venoz qendoror dhe arterial pulmonar | 50.0 |
| c | Llogaritjet hemodinamike | 70.0 |
| 2 | Kateterizimi i zemrës se majte - ventrikulografia | 70.0 |
| 3 | Arteriografija e arterieve periferike | 100.0 |
| 4 | Pulmonare | 120.0 |
| 5 | Cerebrale | 120.0 |
| 6 | Renale | 120.0 |
| 7 | Aortografija | 120.0 |
| 8 | Koronarografija | 150.0 |
| 9 | PCI - balon dilatim | 250.0 |
| 10 | PCI - me implantim të stentit {çmimet e stentit 350-2100 Euro} | 350.0 |
| 11 | Venografija periferike | 50.0 |
| 12 | Venografija qendrore | 60.0 |

Shërbime tjera

| | | |
|---|--|------|
| 1 | Ndërprerja e shtatzënise pa indikacion socio-medicinal | 30.0 |
| 2 | Ndërhyrje kirurgjike me anestezion lokal | 10.0 |
| 3 | Ndërhyrje kirurgjike me anestezion total me laparoskopi në gjinekologji dhe kirurgji si dhe artroskopi në ortopedi | 20.0 |
| 4 | Ndërhyrje kirurgjike me anestezion të përgjithshëm ose spinal | 30.0 |
| 5 | Tretmani fiziatrik ditor për pacientët jashtëspitalor (përfshirë të gjitha procedurat) | 2.0 |
| 6 | Detoksikimet e të alkoolizuarve në kushte ambulantorike | 5.0 |
| 7 | Trajtimi ditor me infuzione në Institucion shëndetësor | 1.5 |

Shtoja 1 - d
Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit tretësor -
INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETIT PUBLIK

| Nr | Lloji i shërbimit | € |
|----|--|------|
| 1 | Analizat laboratorike në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe në Departamentet përkatëse regionale të cilat iu ofrohen drejtpërsëdrejti pacientëve me udhëzim nga mjeku i përgjithshëm, mjeku i familjes ose mjeku specialist | 2.0 |
| 2 | Analizat laboratorike në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik dhe në Departamentet përkatëse regionale të cilat iu ofrohen drejtpërsëdrejti pacientëve pa udhëzim nga mjeku i përgjithshëm, mjeku i familjes ose mjeku specialist | 10.0 |

Shtoja 1 - e
Çmimorja e bashkëpagesave për shërbimet shëndetësore të nivelit tretësor –
QENDRA KOMBËTARE PËR TRANSFUZION TË GJAKUT

| Nr | Lloji i shërbimit | € |
|----|---|-----|
| 1 | Përcaktimi i ABO dhe Rh (D) | 3.0 |
| 2 | Përcaktimi i antitrupave (skrening testi) | 2.5 |
| 3 | Coombsi direkt polispecifik | 2.0 |
| 4 | Coombsi direkt monospecifik | 3.5 |
| 5 | Identifikimi i antitrupave | 5.0 |
| 6 | Testi HIV | 5.0 |
| 7 | Testi HbsAg | 5.0 |
| 8 | Testi HCV | 5.0 |
| 9 | Testi TPH-a | 2.0 |
| 10 | Koha e gjakderdhjes | 0.5 |
| 11 | Koha e protrombinës | 2.0 |
| 12 | Koha e trombinës | 2.0 |
| 13 | PTT | 2.0 |
| 14 | Retraksioni i koagulimit | 1.5 |
| 15 | Numri i trombociteve | 0.5 |

| | | |
|----|---|-----|
| 16 | Faktori II, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 17 | Faktori V, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 18 | Faktori VII, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 19 | Faktori VIII, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 20 | Faktori IX, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 21 | Faktori X, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 22 | Faktori XI, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 23 | Faktori XII, (metoda e koagulimit) | 2.0 |
| 24 | Faktori XIII, (metoda kromogjene) | 2.0 |
| 25 | Testi Rumpel Leed | 0.5 |
| 26 | Dhënia e transfuzionit (ambulantor) vetëm në Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut | 3.0 |

Shtojca 1 - f
